



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:073500

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05490731

**C.nr.304/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm**, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. H. nga fsh.G.e E. K.L.. të cilin me autorizim e përfaqëson V.M..av nga L., kundër të paditurës Komuna e L.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në L., me objekt kontesti kompensim i të ardhurave në bazë të inflacionit, jashtë seance gjyqësore, me dt.22.03.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I.APROVOHET** në tërsi kërkesëpadia e paditëses S. H. nga fsh.G.e E. K.L..si e bazuar.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e L.– Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 23.05.2019 e deri me datë 21.11.2022, t’ia paguaj shumën prej **874.15 euro**, me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.23.04.2022, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 228.00 euro.

**A r s y e t i m**

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim për inflacion, sipas padisë paditësi është mësimdhënësi në SHMP”A. G.” në L.dhe e njëjti i plotëson kushtet e përfitimit të përqindjes së inflacionit në pagën bazë, sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

I autorizuar i paditëses përmes parashtrësës së datës 23.11.2023 ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që t’ia kompensoj paditësit në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 23.05.2019 e deri me datë 21.11.2022 shumën prej 874.15€, me kamatë prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore që do të shkaktohen .

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 01.09.2023, e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkespadiisë dhe se sipas nenit 90 pika 5

te Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës te cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Poashtu sa i përket inflacionit është kompetencë e nivelit qendror e poashtu pika 10 e nenit 35 të Kontratës Kolektive nuk e qartëson se nga kush bëhet përcjellja dhe kush e bënë kompensimin për inflacion. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë (më tej KKAK) në Kosovë (KKAK) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës, me dt. 17.04.2017 dhe Kontratës në vazhdimësi të dt. 22.01.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: kontrata e punës nr.04-112-... dt.02.09.2019 nga e cila vërtetohet se paditësja pagën bazë e ka në shumë prej 459.95€, parashtesa për precizimin e padsisë dt.23.11.2023.

Gjykata përmes kontrata e punës nr.04-112-813-2693 dt.02.09.2019 , ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune të vazhdueshme tek e paditura, dhe paga e tij bazë është 459.95€, të cilën pagë gjykata e ka marr për bazë me rastin e llogaritjes së lartësisë së kërkesëpadsisë .

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë është bazuar në faktin se me Kontratat Kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 respektivisht me nenin 48 të këtyre kontratave është përcaktuar se këto kontrata hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017 respektivisht atë të datës 22.01.2021, në nenin 35.10 thuhet *“Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ku gjykata bazuar në listën e pagës e pagës nuk rezulton se shkalla e inflacionit është futur në pagë, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadsisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të

Republikës së Kosovës përmes web faqes zyrtare ( të bashkangjitura nga e autorizuar e paditëses).

Lidhur me lartësinë e kompensimit sa i përket inflacionit, gjykata ka vendosur duke u bazuar në parashtrësën për precizimin e padisë të autorizuarit të dt.23.11.2023, pasi që të njëjtat janë dhënë, e në veçanti duke marr parasysh pagën që paditësja ka realizuar. Për më tepër kalkulimi i këtyre shumave është bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 35 paragrafi 10 të KKAK-së.

Bazuar në këto të dhëna rezulton se shkalla mesatarja vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës për vitin 2019 respektivisht për periudhë ka qenë 2.7%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2019 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 106.76€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 459.00€ paga x 9muaj = 3,932.10€ x 2.7% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 106.76€, e cila shumë edhe i është aprovuar, si e bazuar.

Për vitin 2020 shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2020 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 11.01€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 459.00€ paga x 12muaj = 5,508.00€ x 0.2% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 11.01€, e cila shumë edhe i është aprovuar.

Për vitin 2021 shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2021 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 187.27€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 459.00€ paga x 12muaj = 5,508.00€ x 3.4% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 187.27€, e cila shumë edhe i është aprovuar.

Për vitin 2022 shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2022 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 569.71€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 459.00€ paga x 11muaj = 4,911.30€ x 11.6% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 569.71€, e cila shumë edhe i është aprovuar.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit tia paguaj shumat e specifikuara në pikën II të dispozitivit.

Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë që është aprovuar sikurse në pikën II të dispozitivit gjykata e ka marr për bazë pagën bazë, ku paditësi është i punësuar si mësimdhënës, e jo pagën bruto për faktin se po të ishte marr për bazë paga bruto atëherë kjo pjesë domosdoshmërisht do ti ishte nënshtruar edhe tatimit në pagë siç parashihet me dispozitat ligjore të Ligjit Tatimit në Pagë.

Meqenëse, ashtu siç është rregulluar e paditura ka pasur detyrim të paditësit tia fut në pagë shkallën e inflacionit të cilën gjë nuk e ka bërë për periudhën kontestuese, në njërin anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, dhe asaj të datës 22.01.2021 sa i përket mjeteve monetare në emër të shkallës së përqindjes së inflacionit dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se *“Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësit.

Poashtu poqëse e paditura e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Andaj, meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me atë se komuna nuk është nënshkruese e kontratës kolektive se nuk kanë parapara mjete financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e përqindjes së inflacionit në pagën bazë obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se “Dispozitat e e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” prandaj është edhe irelevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Gjykata për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditëses ju pranohen shpenzimet procedurale dhe atë ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 104 euro në emër të parashtrimit të padisë, për parashtrësë për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 104-€, si dhe shumë prej 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore, në total shuma prej 228-€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.304/2022 me datën 22.03.2024**

**G j y q t a r i**  
**Zenel Tasholli**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.